



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. 5539/prot.
4

Pogradec, më 12 . 12 2022

VENDIM

Nr. 135, DATË 09 / 12 /2022

PËR

MIRATIMIN E MARRËVESHJES MIDIS BASHKISË POGRADEC DHE SUBJEKTITFONDACIONI "DIAKONIA ALBANIA" PËR FUNKSIONIMIN E QËNDRËS MULTIFUNKSIONALE SOCIALE ARSIMORE TURISTIKENË FSHATIN BISHNICË DHE VËNIEN NË DISPOZICION TËPASURIVE PËRNDËRTIMIN E KËSAJ QËNDRE.

Bazuar ne nenin 9 pika1.1 germa a,b, neni 22/2 ,neni 22, 25, 26 dhe 28, neni 54 germa e te ligjit139/2015"Per veteqeverisjen vendore", Kodi Civil ,Ligji 8743 dt. 22.02.2001 "Per pronat e paluajtshme te shtetit", I ndryshuar, neni 12, Ligjit 8744, dt. 22.02.2001 "Per transferimin e pronave te paluajtshme publike te shtetit ne njesite e qeverisjes vendore", te ndryshuar, Ligjit107/2014"Per planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"te ndryshuar,VKM 408 dt. 13.05.2015 "Per miratimin e Rregullores te Zhvillimit te Territorit" te ndryshuar,

VENDOSI

1. Te miratoje akt marreveshjen bashkangjitur, "Për funksionimin e qendrës multifunksionale sociale arsimore turistikenë fshatin Bishnicë dhe vënien në dispozicion të pasurive për ndërtimin e kësaj qendre",për ushtrimin e funksioneve publike në interes të komunitetit vendor.
2. Ngarkohet Kryetari i Bashkise, për firmosjen e marrëveshjes dhe Drejtoriae Pergjithshme Juridike, dhe e Menaxhimitte Burimeve Njerezore, Drejtoria e Pergjithshme e Planifikimitdhe Zhvillimitte Territorit dhe Komisioni Negocimit per ndjekjen dhe zbatimin e ketij vendimi:
3. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.

KRYETAR I KËSHILLIT

SOTIRAQ MANGËRI



MARREVESHJE

"Për funksionimin e qendrës multifunktionale sociale arsimore turistikenë fshatin Bishnicë dhe vënien në dispozicion tëpasurive përndërtimin e kësaj qendre"

PALET

BashkiaPogradec,perfaqesuar nga kryetari z.Illir XHAKOLLI, më poshtë I cilësuar si "**Bashkia**"

Fondacioni "Diakonia Albania", identifikuar me NIPT L21423453S, me seli ne Tirane,Rruga Bexhet Konxholli nr 9 perfaqesuar nga Drejtore Ekzekutive Znj Aurora Zeqo, më poshtë I cilësuar si "**Fondacioni**".

NENI 1 QËLLIMI

- 1.1. Fondacioni "Diakonia Albania"është Fondacion OJF regjistruar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tirane me vendimin nr 379 date 14.12.2012,qe operon ne fushen sherbimeve komunitare,me seli ne qytetin e Tiranës dhe zone operimi ne fshatin Bishnice Pogradec, I cili ka shprehur interes te zhvilloje projektin e tij social, kulturor etj, ne Fshatin Bishnice Njesia Administrative Velcan, sipas kerkeses per shprehje interesi depozituar ne Bashkine Pogradec ne dt.30.08.2022.
- 1.2. Bashkia Pogradec subjekt juridik publik vendor, I cili ka detyrimin ligjor për ushtrimin e funksioneve në shërbim të komunitetit të përcaktuara qartë në ligjin nr. 139/2015"Per veteqeverisjen vendore", nenet 9/1.1, 22/2, 24, 25, 26, 28, funksione dhe përgjegjësi të cilat përputhen plotësisht me objektivat e projektit që do realizohet nga Fondacioni "Diakonia Albania" në fshatin Bishnicë, duke konsideruar përfitimet e banorëve të zonës si në fushën sociale, arsimore, ekonomike dhe turistike dhe duke marrë parasysh vëndndodhjen e këtij fshati dhe problematikat e banorëve të kësaj zone konsideron të domosdoshme bashkëpunimin për të përmirësuar kushtet e jetesës së komunitetit të kësaj zone kryesisht, por pa u kufizuar, në fushat në fushat:
 - Përmirësimi i qëndrueshëm i mundësive arsimore të të gjithë fëmijëve dhe të rinjve në zonë përmes frekuentimit të shkollës me konvikt.
 - Përmirësimi i mundësive të pjesëmarrjes së fëmijëve dhe të rinjve të pafavorizuar social duke ofruar asistencë socio-pedagogjike dhe orientim e trajnim profesional për grupin përkatës.
 - Rritja e atraktivitetit të zonës për punonjësit potencialë dhe ofertat turistike duke krijuar një qendër fshati me mundësi takimesh mes banorëve dhe punonjësve të qendrës, banorëve dhe të ftuarve të interesuar.
 - Përfshirja e autoriteteve të zonës dhe ruajtja afatgjatë e asistencës sociale nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me autoritetet shtetërore të zonës.
 - Reduktimi i eksodit rural duke krijuar perspektiva pune për të rinjtë, duke centralizuar ofertat e ndihmës dhe duke përmirësuar infrastrukturën.
 - Masat për të promovuar dhe mbajtur detyrat dhe iniciativat komunale në dobi të zhvillimit rajonal ekonomik, social dhe shoqëror të zonës së Mokrës.



- 1.3. Për realizimin e këtij projekti të përbashkët, Bashkia Pogradec ve në dispozicion për përdorim 20 (njëzet) vjekar me të drejtë ripërtëritjeje për të njëjtin qëllim edhe pasuritë:
- Nr.333/34, mesip.849.6m2,ZK1194;
 - Nr.333/2,mesip.1325 m2,ZK1194;
 - Nr.333/9,mesip.697 m2,ZK1194;
- 1.4. Fondacioni “Diakonia Albania”, *eshte zhvilluesi i cili do te jete dhe investitori për ndërtimin e ambjenteve të nevojshme për realizimin e këtij projekti mbi tokën në pronësi të Fondacionit “Diakonia Albania” dhe tokës në pronësi të Bashkisë*, të cituara më sipër, të cilat Bashkia i ve në dispozicion me të drejtë përdorimi për 20 (njëzet) vjet me të drejtë ripërtëritjeje marrëveshjeje për të njëjtin qëllim.
- 1.5. Bashkia Pogradec, si bashkëpunëtore në këtë projekt dhe si pronare e pasurive identifikuar në pikën 1.3.,do të përdorë ambjentet me punonjës të saj vetem për realizimin e funksioneve dhe përmbushjes së misionit të projektit sipas pikës 1.2,funksione këto edhe të Bashkisë Pogradec.
- 1.6. Procedura për nenshkrimin dhe zbatimin e marrëveshjes realizohet në përputhje me parimet e ruajtjes dhe garantimit të interesit publik,si dhe ruajtjen dhe rritjen e vlerës ekonomike të pronës së Bashkisë Pogradec.

NENI 2

OBJEKTI

- 2.1.Objekti kryesor i kësaj marrëveshjeje është realizimi dhe implementimi me sukses i projektit për ngritjen dhe vënien në funksionim të Qendrës multifunktionale sociale, kulturore, arsimore në fshatin Bishnicë. Në këtë kuptim, Bashkia Pogradec dhe Fondacioni “Diakonia Albania”si bashkërealizuese e këtij projekti vënë në dispozicion të realizimit të këtij projekti:
- 2.1.1. Kapacitete e tyre njerëzore për të shërbyer në ambjentet të cilat do të ndërtohen dhe sipas mundësisë edhe mjete financiare për të realizuar funksionet e saj publike të cituara më sipër në bashkëpunim me fondacionin “Diakonia Albania”.
- 2.1.2. Bashkia në cilësinë e pronaresë pasurive të cituara në pikën 1.3.,për përdorim vetëm për qëllimin e përcaktuar në nenin 1 dhe do ta vendosë në dispozicion të projektit të mësipërm në mënyrë që zhvilluesit Fondacionit “Diakonia Albania” ta përdorë për të ndërtuar një Qendër të re Multifunktionale.
- 2.1.3. Fondacioni ve në dispozicion të realizimit të projektit tokat në pronësi të tij dhe mjetet financiare për ndërtimin e qendrës multifunktionale si dhe funksionimin e saj.
- 2.2.Me realizimin e projektit, Bashkia Pogradec nga nëra anë dhe Fondacioni “Diakonia Albania” nga ana tjetër do të lejojë në bashkëpunim me njëri tjetrin zhvillimin e aktiviteteve për komunitetin e zonës vetëm sipas qëllimeve të përcaktuara në këtë marrëveshje.
- 2.3.Cdo ndryshim destinacioni, përpara ose pas afatit të përdorimit 20 (njëzet) vjekar, bën që kjo marrëveshje të prishet dhe secila palë të kërkojë nga pala tjetër të gjitha të drejtat që kanë mbi pronat e tyre.

NENI 3

BAZA LIGJORE

- 3.1.Nenin 9 pika1.1 germa a,b,neni 22/2,neni 22, 25, 26 dhe 28, neni 54 germa e të ligjit139/2015" Per veteqeverisjen vendore"
- 3.2.KodiCivil



- 3.3.Ligji8743dt. 22.02.2001 "Per pronat e paluajtshme te shtetit", I ndryshuar,
- 3.4.Neni 12, Ligjit 8744, dt. 22.02.2001 "Per transferimin e pronave te paluajtshme publike te shtetit ne njesite e qeverisjes vendore", te ndryshuar,
- 3.5.Ligjit107/2014"Per planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"te ndryshuar,
- 3.6.VKM 408 dt. 13.05.2015 "Per miratimin e Rregullores te Zhvillimit te Territorit" te ndryshuar.

NENI 4

TE DREJTAT DHE DETYRIME TE PALEVE

4.1.Fondacioni "Diakonia Albania", PALA ZHVILLUESE:

- 4.1.1. Fondacioni "Diakonia Albania" merr përsipër të sigurojë financimin për ngritjen e qendrës multifunkionale për ndërtimin e ambjentëve të nevojshme për të sipas projektit të paraqitur në Bashki për gjithë projektin (për territorin në pronësi të saj dhe territorin në pronësi të Bashkisë.
- 4.1.2. Fondacioni merr përsipër të bashkëpunojë me bashkinë për të siguruar funksionimin normal të qendrës multifunkionale duke siguruar financime për aktivitetet duke u siguruar që çdo aktivitet i saj të shërbejë për përmirësimin e cilësisë së jetesës së banorëve të zonës.
- 4.1.3. Fondacioni në cilësinë e zhvilluesit do të përgatise dhe vendosen ne dispozicion te Bashkise Pogradec projekti ne ndertim qe synon te zhvilloje ne baze te te cilit do aplikojte per leje zhvillimi /ndertimi. Për këtë qëllim Fondacioni kryen të gjitha detyrimet e mëposhtme:
- 4.1.3.1. Përgatit gjithë dokumentacionin e nevojshem per tu paraqitur ne organet perkatese dhe te kerkuara nga Bashkia Pogradec, me shpenzime te veta.
- 4.1.3.2. Do të realizojë dhe do të perfundojë punimet sipas projektit te miratuar dhe brenda afateve te percaktuara ne lejet perkates
- 4.1.3.3. Fondacioni do te regjistrojë ndërtimet që do realizojë por pa ndryshuar pronësinë e tokës në pronësi të Bashkisë Pogradec.
- 4.1.3.4. Regjistrimi i objekteve të ndërtuara mbi pronën e Bashkisë Pogradec duhet të kenë shënimin e titujve "në përdorim" sipas parashikimeve të nenit 56 të ligjit nr. 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" me ndryshime.
- 4.1.3.5. Të sigurohet që pas ndërtimit të bëhet shënimi në kartelë për të mos u tjetërsuar nga fondacioni në favor të personave privatë. Kopje e shënimit duhet të dorëzohet në Bashkisë Pogradec.
- 4.1.3.6. Nëse Fondacioni kërkon të transferojë te drejtat dhe detyrimet e zhvillimit (lejes se ndertimit) te nje i trete, nuk mund te beje transferimin pa marre me pare miratimin me shkrim te Bashkise Pogradec. Ne çdo rast transferimi i ketyre te drejtave dhe detyrimeve dot e behet se bashku me transferimin e te drejtave dhe detyrimeve te marra persiper ne kete marreveshje.
- 4.1.3.7. Zhvilluesi detyrohet dhe eshte personi pergjegjes pezbatimin e legjislacionit ne fuqi per marredheniet e punes, politikat e sigurimeve dhe te drejtave te punonjesve qe duhet te ndiqen, nga prej tij, gjate zbatimit te punimeve dhe gjithe kohezgjatjes se kesaj marreveshjeje.
- 4.1.3.8. Ne rast mospermbushje te detyrimeve te percaktuara ne kete marreveshje, Zhvilluesi nuk ileskohet certifikata e perdorimit apo leja e shfrytezimit.
- 4.1.3.9. Fondacioni merr përsipër te paguaje vleren perkatese te paguar nga Bashkia Pogradec, ne rastin e kryerjes se ekspertizave te ndryshme ,nepermjet eksperteve private tw fushave perkates.



4.1.3.10. Çdo takse apo tarife qe rrjedh si pasoje e marreveshjes midis Bashkise Pogradec dhe fondacionit si zhvillues privat eshte ne ngarkim te ketij te fundit, me perjashtim te tarifes se pajisjes me dokumentin e pronesisë ne emer te Bashkise Pogradec.

4.2.PËR BASHKINË POGRADEC:

- 4.2.1. Të angazhohet maksimalisht duke bashkëpunuar me fondacionin për të realizuar projektin, objekt të kësaj marrëveshjeje të cilësuar në nenin 2.
- 4.2.2. Te vendose ne dispozicon te fondacionit,sipermarresit pronen e saj me qellim zhvillimin e saj nga investitori,vetëm për të realizuar projektin për qëndrën multifunksionale pa u zhveshur nga e drejta e pronësisë duke vënë në dispozicion të drejtën reale të përdorimit të tokës.
- 4.2.3. Të jape garanci dhe ta mbroje sendin nga shqetesimet e te treteve;
- 4.2.4. Çdo sipërfaqe ndertimore e cila do të përdoret prej bashkisë do të përdoret vetem per realizimin e funksioneve dhe permbushjes se misionit te Bashkise Pogradec në kuadër të objektivave të projektit dhe në dakortësi me fondacionin.
- 4.2.5. Pas përfundimit te projektit,me urdher te Kryetarit te Bashkise ngrihet grupi i punes per ndjekjen dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje.
- 4.2.6. Të verë në dispozicion të qëndrës multifunksionale burimet njerëzore, informacione dhe cdo mjet tjetër të dakortësuar me fondacionin për të siguruar kryerjen korrekte të shërbimeve në qëndër me përfitim të komunitetit të zonës.

NENI 5 FORCAMADHORE

- 5.1.Per qellimet e ketij neni "Force Madhore" do te thote nje ngjarje jashte kontrollit te paleve mbi fajin ose neglizhimin dhe e paparashikueshmerine nga ana e tyre. Ngjarje te tilla mund te perfshijne, lufta ose revolucionet, zjarri, permbytja, termeti, epidemite, etj.
- 5.2.Palet perjashtohen nga detyrimet e ndersjellta ne rast se mosekzekutimit I kesaj kontrate ndodh per shkak te Forces Madhore.

NENI 6 SANKSIONET

- 6.1. Ne rast mosekzekutimi të detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje per faj te njeres pale, pala tjeter ka te drejte te kerkoje permbushjen ne natyre te detyrimit, dhe nese kjo nuk eshte e mundur, mund te kerkojne shperblim demi i cili i korespodon vleres se sendit qe debitori shkemben duke perfshire dhe fitimin e munguar.
- 6.2. Cdo devijim nga qëllimi I kësaj kontrates e funksionit të qëndrës në shërbim të komunitetit të zonës I jep të drejtën Bashkisë të prishë kontratën dhe të kërkojë lirimin e pronës së saj nga cdo object I vendosur mbi të.

NENI 7 AFATET

- 7.1. Data e hyrjes ne fuqi e marreveshjes do te jete data e nenshkrimit te saj dhe shtrin efektet deri ne përfundim të projektit.
- 7.2. Pas përmbushjes së afatit 20 (njëzet) vjecar për të drejtën e përdorimit të tokës, palët mund të dakortësojnë vazhdimin e marrëdhënies së tyre. Rinovimi në heshtje është I vlefshëm.



NENI8

ZGJIDHJA EMARREVESHJES

- 8.1. Marrevëshja zgjidhet me mbarimin e afatit të përcaktuar në të.
- 8.2. Marrevëshja mund të zgjidhet para afatit:
- 8.2.1. Me pëlqim midis paleve.
 - 8.2.2. Kur pronarumbetteresishtosedemtohetpershkaktenjeforcemadhore.
 - 8.2.3. Kur fondacioni pushon së ekzistuari, ose projekti përfundon. Në këtë rast të gjitha objektet e ndërtuara të qëndrës multifunksionale kalojnë për Bashkinë Pogradec dhe përdoren vetëm për qëllimin e ngritur në funksion të banorëve të zonës.

Neni 9

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE.

- 9.1. Per mosmarreveshjet e ndryshme qe mund te lindin gjate zbatimit te kesaj marreveshje,palet zotohen t'I zgjidhin me mirekuptim,ne rast te kundert,competente per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Pogradec dhe/ose Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Korçe.
- 9.2. Ne rast mos ekzekutimi te marreveshjes apo shkeljeve te kryera nga palet ,ato detyrohen ne menyre te ndersjellte te njoftojne njera-tjetren me shkrim per shkelje te konstatuara,duke vendosur nje afat 1 mujor per rregullimin e tyre.
- 9.3. Ne rast mos perbushjes se detyrimeve te parashikuara ne marreveshje, ne menyre te perseritur, ndaj paleve do te aplikohen sanksionet e parashikuara ne legjislacionin ne fuqi, Kodin Civil I cili rregullon marredhenien juridike mes paleve kontraktore dhe çdo rregullim ligjor I aplikueshem ne kete rast.

Neni 10

DISPOZITA TË FUNDIT

- 10.1. Kjo marrëveshje hartohet në gjuhën shqipe në 2 (dy) kopje, nga një për secilën palë.
- 10.2. Pasi u lexua, kuptua dhe dakortësua nga palët firmoset regullisht prej tyre.

Bashkia Pogradec Fondacioni "Diakonia Albania"

Kryetari

Ilir XHAKOLLI

Drejtore Ekzekutive

Aurora ZEQO

